



Prezantim i përgjithshëm i masave të përkohshme

Çfarë janë masat e përkohshme?

Sipas Nenit 39 të Rregullave të Gjykatës, Gjykata mund t'i caktojë masa të përkohshme cilitdo [Shteti palë të Konventës](#). Masat e përkohshme janë masa urgjente të cilat, në përputhje me praktikën konstante të Gjykatës, zbatohen vetëm kur ekziston **një rrezik i menjëhershëm për një dëm të pariparueshëm** (shih [Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë](#) [DhM], nos. 46827/99 dhe 46951/99, § 104, 4 shkurt 2005 dhe [Paladi k. Moldavisë](#) [DhM], no. 39806/05, §§ 86-90, 10 mars 2009).

Masat e përkohshme zbatohen vetëm në rrethana të kufizuara: rastet më tipike janë ato në të cilat ekziston rreziku për një

- kërcënim ndaj jetës (kur situata lidhet me Nenin 2 të Konventës) ose
- keqtrajtim, i cili është i ndaluar nga Neni 3 i Konventës (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose poshtërues).

Në raste tepër përjashtimore, ato mund të zbatohen edhe ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me të drejta të tjera të parashikuara në Konventë.

Shumica e masave të përkohshme të caktuara kanë të bëjnë me procedurat e dëbimit ose ekstradimit ose me gjendjen shëndetësore të ankuesve në vendet e burgimit.

Në përputhje me praktikën e Gjykatës, kërkesat që janë qartazi jashtë fushëveprimit të Nenit 39, si kërkesat e parakohshme dhe kërkesat e paplota/të pabazuara normalisht nuk i parashtrohen gjyqtarit për vendim dhe refuzohen.

Mënyra dhe periudha kohore në të cilën trajtohen kërkesat për masa të përkohshme

Kërkesat për masa të përkohshme shqyrtohen rast pas rasti me procedurë të shkruar. Ato trajtohen me **prioritet**, përveç rasteve kur kërkesa përdoret haptazi si taktikë vonuese.

Ankuesit informohen për vendimet e Gjykatës në lidhje me kërkesat për masa të përkohshme nëpërmjet faqes së GJEDNJ-së për Neni 39, me faks ose me postë. Vendimet që refuzojnë zbatimin e Nenit 39 nuk mund të apelojnë.

Kohëzgjatja dhe heqja e masave të përkohshme të caktuara sipas Nenit 39

Masat e përkohshme mund të caktohen përgjatë kohëzgjatjes së procedurës para Gjykatës ose për një periudhë të kufizuar kohore.

Një urdhër bazuar në Nenin 39 mund të hiqet në çdo kohë me vendim të Gjykatës. Për më tepër, duke qenë se një urdhër bazuar në Nenin 39 është i lidhur me procedurat para Gjykatës, masa mund të hiqet nëse ankesa e themelit nuk konfirmohet.

Largimi i një personi në një shtet anëtare

Kur një person të cilit i është refuzuar kërkesa për një masë të përkohshme largohet drejt një shteti tjetër anëtar, ai ose ajo, nëse është e nevojshme, mund të paraqesë një kërkesë të re kundër atij shteti sipas Nenit 39 të Rregullave të Gjykatës ose një kërkesë sipas nenit 34 të Konventës.